



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

TEPELENË

Nr.1917/4.prot.

Tepelenë më, 01 . 09.2022

**V E N D I M**

**Nr.68.Datë.31.08.2022**

**“Për shprehjen e pëlqimit në parim për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor ndodhur në Bashkinë Tepelenë me qëllim studimin mbi potencialin e energjise së erës”**

Në mbështetje të nenit 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor” dhe të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, ligjit nr.139/2015 “Per vetqeverisjen vendore”; ligjit 115/2014 “Per ndarjen administrativo territoriale te njesive te qeverisjes vendore ne Republiken e Shqiperise” i ndryshuar; ligjit nr.9743 date 22.02.2001 “Per pronat e paluajtshme te shtetit”; Udhezimit nr.1 date 9.6.2016 te Ministrit te Mjedisit “Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e te miratimit te kerkesave per dhenien ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik”; shprehjes se interesit te subjektit ALBPOWER Shpk nr.8 date 29.6.2022 protokolluar prane bashkise me nr.1521 date 29.06.2022; mbështetur në të dhënat e certifikatave të pasurive rezultojnë që sipërfaqet e kërkuara bëjnë pjesë në inventarin e Bashkise Tepelene përkatësisht të njësive administrative Kurvelesh dhe Qendër;

**V E N D O S I:**

1. Të jape pëlqimin në parim për dhënien me qira për pasuritë si më poshtë, sipas funksionit dhe destinacionit që kanë:
  - Pasuritë me nr.514, 515 dhe 516, përkatësisht parcelat nr.29, 30, 32 të Ekonomisë Kullosore Dukaj-Luzat, ZK 3661, fshati Turan, lloji i pasurisë “Kullotë” në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas inventarit të Bashkise Tepelene me VKM nr.433/2016 të ndryshuar.
  - Pasuritë me nr.1546/1, ZK 3252, përkatësisht parcela nr.33 e Ekonomisë Kullosore Dukaj-Luzat, fshati Salari, lloji i pasurisë “Kullotë” në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas inventarit të Bashkise Tepelene me VKM nr.433/2016 të ndryshuar.

- Parcela nr. 36 dhe 37 e Ekonomise Kullosore Dukaj-Luzat, fshati Salari, lloji i pasurisë "Kullotë" në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas inventarit të Bashkisë Tepelene me VKM nr.433/2016 të ndryshuar.
- Pasuritë me nr.909, 907, 900, perkatesisht parcelat nr. 54c, 56b dhe 57b të Ekonomise Pyjore Dukaj-Luzat, fshati Luzat, lloji i pasurisë "Kullotë" në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas inventarit të Bashkisë Tepelene me VKM nr.433/2016 të ndryshuar.
- Pasuritë me nr.889, 890, 921, perkatesisht parcelat nr. 10c, 11b dhe 12b të Ekonomise Pyjore Dukaj-Luzat, fshati Luzat, lloji i pasurisë "Pyll dhe Kullotë" në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas inventarit të Bashkisë Tepelene me VKM nr.433/2016 të ndryshuar.
- Parcelat nr. 1, 2 dhe 3 të Ekonomise Kullosore Kurevelesh, fshati Lekdush, lloji i pasurisë "Kullotë" në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas inventarit të Bashkisë Tepelene me VKM nr.433/2016 të ndryshuar.

Të dhënat e tokave bujqësore sipas tabelës së mëposhmit:

Nr	Njësia administrative/fshati	Zona kadastrale	Nr pasurie	Nr. Parcele	Sipërfaqe m <sup>2</sup>
1	Kurvelesh/ Lekdush	2404		1, 2, 3	19925

Nr	Njësia administrative/fshati	Zona kadastrale	Nr pasurie	Nr. Parcele	Sipërfaqe m <sup>2</sup>
1	Qendër/ Turan	3661	514, 515, 516	29, 30, 32	28300
2	Qendër/ Salari	3252	1546/1	33	
3	Qendër/ Salari	3252	---	36, 37	7850
4	Qendër/ Luzat	2541	909, 907, 900	54c, 56b, 57b	4885
5	Qendër/ Luzat	2541	889, 890, 921	10c, 11b, 12b	8900

2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik dhe elementeve të tij, në mbështetje të Udhëzimit nr. 1, datë 6.6.2016 të Ministrit të Mjedisit "Per rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e të miratimit të kerkesave për dhenien në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik" si dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit kullosor/pyjor

3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespondencës, plotësimin e dokumentacionit si dhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 1, datë 6.6.2016 të Ministrisë të Mjedisit “Për rregullat e procedurat e kerkimit, shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhenien në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik”, ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Qiradhënies së Pyjeve e Kullotave publike.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

**KRYETAR**

**Elvis Shehu**

Sekretari I Këshillit Bashkiak  
Valbona Çela



Miratuar me 12( dymbëdhjetë) vota  
Vota Pro 12 ( dymbëdhjetë)  
Vota Kundër -  
Vota Abstenim -  
Zbardhur më datë 01.09.2022.